



## Mësimdhënia bazuar në hulumtim

### Research Based Teaching

# “Inquiry based experiments using paper microfluidic devices”

**Udhëheqës i projektit: Prof.Ass.Dr.Liridon Berisha**

Më datë 26 Maj 2023 u mbajt ceremonia përmbyllëse e projektit “Inquiry based experiments using paper microfluidic devices” financuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit. Në kuadër të përmbylljes së projektit u prezantuan projektet hulumtuese të studentëve Dionita Shabani, Dafina Abdyli, Florina Gojani, Festina Mehanolli, Kanina Mula, Anesa Zorra, Andi Halilaj dhe Murat Beqiraj.



Zhvillimi i eksperimenteve bazuar në hulumtim krijon mundësinë që studentët të shfaqin kreativitetin e tyre duke ofruar zgjidhje për problemet me të cilat ballafaqohet sot njerëzimi duke krijuar pajisje mikrofluidike të cilat mundësojnë realizimin e testeve kimike në monitorimin e cilësisë në mjedis, ushqim, shëndet etj. Përmes kësaj qasje studentët arrijnë të krijojnë produkte inovative për analizën dhe kontrollin e mjedisit, ushqimit ose shëndetit duke synuar edhe në zhvillimin e këtyre produkteve në nivel gatishmërie teknologjike sa më të lartë. Të menduarit kritik rreth zgjidhjes së problemeve të cilat janë si pikënisje e punës së studentëve bazuar në problemet që kërkojnë zgjidhje, nxit zhvillimin e shkathtësisë së ndërmarrësisë dhe fuqizon lidhjen e akademisë me industri duke ofruar zgjidhje të reja me kosto të lira dhe të lehta për përdorim.

Përmes këtij projekti është krijuar infrastruktura e nevojshme për realizimin e ushtrimeve laboratorike bazuar në hulumtim në fushën e kimisë analitike duke u ofruar mundësi studentëve në zhvillimin e shkathtësisë në hulumtim dhe zgjidhjen e problemeve. Njëkohësisht përmes kësaj qasje ka filluar transformimi i mënyrës së vlerësimit klasik në vlerësim bazuar në projekte dhe hulumtim duke drejtuar studentët drejt zhvillimit të shkathtësisë të nevojshme për tregun e punës